



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 4200 Prot
12

Gramsh më 07.01.2022

VENDIM

Nr. 131, datë 29.12.2021

PËR

**“ MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË OBJEKTIT “OBJEKTI I RI” NDODHUR NË
“ISH-UZINA E PILAVE” NË PRONËSI TË BASHKISË”**

Në zbatim të VKM Nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve ,të procedurës së dhënies me qira ,enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (i ndryshuar); Udhëzimit të MZHETTS Nr.13,datë 26.04.2018 “Për zbatimin e VKM nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve ,të procedurës së dhënies me qira ,enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore(të ndryshuar),neneve 784 -800, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, si dhe Ligjit Nr.139/2015 ,datë 17.12.2015 “Per vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar)neni 8,pika 2 ; neni 54 shkronja (e) , Këshilli Bashkiak :


VENDOSI

1. Të miratojë dhënien me qira të objektit dhe truallit të lirë funksional të tij,në pronësi të bashkisë Gramsh me vendndodhje e të dhëna si më poshtë :
 - “Objekti i ri” 2 -katësh me sip.ndërtimi 1220 m² kati përdhe dhe 1220 m² kati i parë, si dhe truall të lirë funksional me sip. 1783 m² sipas genplaneve bashkëlidhur ,ndodhur në Zonën Kadastrale Nr.1842 ,Ish-Uzina e Pilave Gramsh me nr.pasurie 10/307 .
2. Afati i dhënies me qira të jetë deri 20-vjet me qëllim ushtrimin e veprimtarive ekonomike.
3. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurimit publik dhe elementeve të tij në mbështetje të VKM Nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve ,të procedurës së dhënies me qira ,enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (i ndryshuar); Udhëzimit të MZHETTS Nr.13,datë 26.04.2018 “Për zbatimin e VKM nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve ,të procedurës së dhënies me qira ,enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore(të ndryshuar),
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ,Drejtoria Juridike, Zyra e Menaxhimit të Aseteve Vendore dhe Drejtoria e Planifikimit,Zhvillimit të Territorit,Burimeve Natyrore.

5. Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr.80 ,datë 27.09.2017 ‘‘Mbi miratimin e dhënies me enfitëozë të objektit ‘‘objekti i ri’’ ndodhur në ‘‘ish-uzina e pilave’’ në pronësi të bashkisë’’,shfuqizohet.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.


Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

GRETA LENA



Konceptoi: Xh. Gjini

Pranoi: G. Lena

Dosja nr: _____

Afati i ruajtjes: _____

